

Studime Doktorale

Rreth programit

Universiteti Clemson në Karolinën e Jugut SHBA, në bashkëpunim me SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, Tiranë, ofrojnë programin e Doktoratës “Studime ndërkombëtare për familjen dhe komunitetin”. Programi i ofruar nga Universiteti Clemson zhvillohet në ambjentet e SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”.

Universiteti Clemson dhe SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” përmes këtij programi synojnë të afrojnë së bashku profesionistë dhe kërkues shkencorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe vende të tjera të Ballkanit, me qëllim krijimin e një grupi profesionistësh dhe studiuesish elitare, duke ju mundësuar të kualifikohen me cilësi të lartë, kosto të ulët dhe pa u shkëputur nga aktivitetet e tyre të përditshme.

Ky program është një mundësi e shkëlqyer kualifikimi për profesionistët e shkencave sociale, humane, ligjore, mjekësore, etj., që kanë përvojë në këtë fushë dhe kërkojnë të thellojnë edhe më shumë dijet e tyre shkencore. Duke studiuar në Tiranë, studentët do të kenë mundësi të punojnë me programin e një universiteti prestigjioz amerikan, profesorët dhe metodat e tij dhe në fund do të marrin titullin Ph.D. nga Universiteti Clemson.

Përshkrimi i kurseve

- **FC810 Jeta në komunitetin global (E detyrueshme)**
Shqyrton perspektivat globale dhe tendencat që përkojnë me mirëqenien sociale, psikologjike, ekonomike dhe fizike të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, si dhe grupeve të zgjedhura të organizuara, përfshirë familjen, institucionet parësore të shoqërisë dhe shoqërinë civile; shembuj të adaptimit dhe rezistencës ndaj globalizimit; shqyrtimin e tensioneve midis nevojave të tregut të sotëm, shoqërisë, individëve dhe familjeve; analizën dhe shqyrtimin krahasues të efekteve të globalizimit në jetën e përditshme në vendet e zgjedhura për analizë.
- **FCS 811 Zhvillimi human dhe jeta e familjes në kontekstin kulturor (E detyrueshme)**
Shqyrton kontekstin kulturor në zhvillimin e njeriut dhe jetës familjare, ndikimet e kulturës në zhvillimin fizik, njohës dhe social të njeriut dhe familjes; vlerësime analitike dhe krahasuese të ndikimeve të përvojave të ndryshme mjedisore në funksionimin e individit dhe familjes; zbatimet praktike të perspektivës ndërkulturore për zhvillimin njerëzor dhe të familjes; shqyrton statusin e zhvillimit njerëzor në mbarë botën dhe efektet e globalizimit në zhvillimin njerëzor në SHBA dhe kulturat e përzgjedhura jashtë vendit. Parakusht: FCS 810 ose sipas miratimit të pedagogut.
- **FCS 836 Studime në fushën kulturore (E detyrueshme)**
Zgjeron njohuritë e studentëve për natyrën e familjes dhe jetës në komunitet në rajone të ndryshme të botës (p.sh. në Evropën Lindore; Lindjen e Mesme; Amerikën Latine; Karaibet, etj.). Temat përfshijnë tendencat politike, sociale dhe ekonomike; transformimet politike dhe ekonomike; çështjet ndërkulturore; globalizimin; të drejtat e njeriut; dhe shoqërinë civile.
- **FCS 820 Legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut (E detyrueshme)**

Shqyrton legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Në këtë kurs i kushtohet vëmendje origjinës së legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, shfaqjes së legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut, pozitën e SHBASë në lidhje me ratifikimin e traktateve të të drejtave të njeriut, proceset për monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut nëpër botë, dhe trajtimin e të drejtave të njeriut në gjykata. Temat përfshijnë diskutimin e parimeve kryesore, të cilat qëndrojnë në themel të dispozitave të traktateve dhe tendencat në zhvillimin e traktateve.

- **FCS 851 *Legjislacioni ndërkombëtar dhe politikat për çështjet e fëmijëve (Me zgjedhje)***
Analiza krahasuese e ligjit dhe politikave mbi çështjet e fëmijëve. Në këtë kurs i kushtohet vëmendje instrumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, veçanërisht Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe koncepteve gjegjëse në ligjet dhe politikat e vendeve të ndryshme, përfshirë dhe SHBA.
- **FCS 852 *E drejta shëndetësore (Me zgjedhje)***
Shqyrton marrëdhëniet mes shëndetit dhe të drejtave të njeriut duke e vënë theksin në zbatimin e qasjes së bazuar mbi të drejtat që lidhen me interesat shëndetësore të fëmijës, familjeve dhe komuniteteve. Temat përfshijnë diskutimin e përmbajtjes dhe formave të të drejtës për shëndet dhe të prirjeve të reja në të drejtën për shëndetin dhe të drejtat e njeriut. Parakusht: FCS 820 ose sipas miratimit të pedagogut.
- **FCS 830 *Zhvillim komuniteti: parimet dhe praktikat (E detyrueshme)***
Teoria krahasuese dhe praktika e zhvillimit të komunitetit, ndërtimi i komunitetit dhe transformimet e komunitetit që mbështesin mirëqenien e fëmijëve, të të rinjve dhe familjes; shembuj të zhvillimit të komunitetit në SHBA dhe shembuj të përzgjedhur nga vende të tjera.
- **FCS 831 *Transformimi i komunitetit (E detyrueshme)***
Një kurs i avancuar për teorinë e transformimit të komunitetit, besimet dhe praktikat fetare; diskutimi dhe ilustrimi i ndryshimeve të mëdha të paradigmave brenda tri dekadave të fundit në mënyrën sesi është menduar dhe zbatuar zhvillimi i komunitetit; studimet e rasteve për transformimin e komunitetit nga vendet e zgjedhura.
Parakusht: FCS 830 ose sipas miratimit të pedagogut.
- **FCS 832 *Politikat dhe programet në shërbimet humane (Me zgjedhje)***
Shqyrton filozofinë, teorinë dhe parimet për organizimin e shërbimeve humane në të gjitha shtetet e përzgjedhura, duke theksuar strategjitë dhe pengesat për zhvillimin e bashkëpunimeve brenda dhe ndërmjet organizatave qeveritare dhe joqeveritare. Me interes të veçantë është mbështetja e fëmijëve dhe e familjes në nivel të komunitetit (p.sh., lagje, fshat, dhe qytet); zbutja e varfërisë, kujdesi shëndetësor; arsimimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme; si dhe përkrahja për të moshuarit.
- **FCS 833 *Ndihma humanitare (Me zgjedhje)***
Hyrje në ndihmat humanitare me theks të veçantë në studimin e terminologjisë përkatëse dhe konceptet që lidhen me refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit. Temat e mbuluara përfshijnë sfondin historik, statusin aktual, faktorët përcaktues, çështjet ligjore, si dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore. Pjesë me rëndësi janë edhe përdorimi i shumë shembujve aktualë dhe të kaluar nga përvoja me refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit si dhe nga konfliktet etno-politike dhe të terrorizmit si burimet kryesore të krizave humanitare.

FCS 830 ose sipas miratimit të pedagogut.

- **FCS 892 Skicimi i kërkimit dhe metodat sasiore I (E detyrueshme)**
Kursi analizon procesin dhe teknikat e kërkimit social, duke i vënë një theks të veçantë metodave sasiore dhe të kombinuara. Çështjet përfshijnë natyrën dhe bazat e kërkimit; matjet; kampionimin; metodat e mbledhjes së të dhënave; si dhe planin e kërkimit. Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të kërkimeve në nivel ndërkombëtar.
- **FCS 892 Skicimi i kërkimit dhe metodat sasiore II (E detyrueshme)**
Ky kurs mbulon çështje të skicimit të kërkimit me shumë ndryshore, duke theksuar elementet kritikë të kërkimit në përzgjedhjen e metodave të përshtatshme kërkimore. Kursi analizon parimet më të rëndësishme të skicimit të kërkimit. Vëmendje e veçantë i kushtohet kërkimit në terren dhe me bazë në komunitet dhe kërkimit në nivel ndërkombëtar. Kursi është një kombinim i leksioneve me diskutimet.
- **FCS 840 Tema të kërkimeve ndërkombëtare dhe për shoqërinë (Me zgjedhje)**
Mbulon çështjet e zgjedhura në skicimin e kërkimit dhe analizën e të dhënave ku vëmendje e veçantë i kushtohet kërkimit në terren dhe atij në komunitet, si dhe kërkimit në nivel ndërkombëtar.
- **ANTH 603 Metoda cilësore (me zgjedhje)**
Metodat dhe teknikat e kërkimit cilësor në terren, duke përfshirë vëzhgimin me pjesëmarrje, intervistimin etnografik, analizën e të dhënave dhe shkrimin e raportit.
- **SOC 805 Kërkimi vlerësues (me zgjedhje)**
Metodat e kërkimit dhe teknikat e menaxhimit të të dhënave me ndihmën e kompjuterit dhe analizat e përdorura në vlerësimin e politikave, veprimeve, organizimin dhe efektivitetin e programeve sociale në sektorin privat dhe publik; si dhe paketat e softwarëve mikrokompjuterike që përdoren për këto qëllime.
- **SOC 803 Skicimi i sondazhit (me zgjedhje)**
Parimet e skicimit të sondazhit kërkimor, procedurat dhe teknikat që përdoren në sociologjinë e zbatuar, instrumentet; mbledhja, menaxhimi dhe interpretimi i të dhënave.
- **FCS 991 Disertacioni (18 kredite)**
Puna për disertacionin fillon pas fitimit të statusit të kandidatit për gradën doktor.

PSE TË ZGJIDHNI KËTË PROGRAM DOKTORATE

- Ky program ofron një sintezë ndërdisiplinare mes të drejtave ndërkombëtare të njeriut, çështjeve të zhvillimit, politikave shëndetësore dhe kërkimit shkencor.
- Programi ofrohet nga Universiteti Clemson, një institucion amerikan i arsimit të lartë, me reputacion të lartë, i vlerësuar si një lider në fushën e arsimit të shkencave sociale në botë.
- Ky është programi i parë i këtij lloji i ofruar në një universitet në Ballkan, me vendndodhje në Tiranë, një qytet metropol.
- Të gjitha lëndët do të ofrohen nga pedagogët e Universitetit Clemson.
- Pedagogët e UC do të udhëheqin kërkimet e studentëve doktorantë.

- I gjithë personeli akademik i UC është i kualifikuar dhe me përvojë ndërkombëtare në studime të familjes dhe komunitetit.
- Doktoranti/ja do të jetë student i Universitetit Clemson, gjë që do t'ju bëjë të mundur të përdorni bibliotekën online dhe sistemin online të mësimdhënies të UC, ndërkohë që do të qëndroni në vendin tuaj ku banoni.
- Diploma PhD do të lëshohet nga Universiteti Clemson.
- Për studentët doktorantë nga Ballkani do të aplikohen tarifa shkollimi shumë më të ulëta se ekzistueset.
- Duke përdorur një format të përzier të kursit, programi përgjithësisht i lejon studentit doktorant të ruani vendin e punës në vendin e tij.

KRITERET E PRANIMIT

- Për këtë program janë të mirëpritur aplikantë me formim nga shkencat sociale, studimet humane, shkencat juridike, mjekësia dhe studimet ndërkombëtare. Është e nevojshme të theksohet se zotërimi i përvojave përkatëse profesionale, akademike dhe kërkimore vlerësohet jashtëzakonisht e rëndësishme për t'u kualifikuar dhe për t'u pranuar në program.
- Aplikues në program mund të jenë studentë nga të gjitha vendet e Ballkanit.
- Aplikantët duhet të kenë një diplomë master nga një program i akredituar. Përveç performancës së lartë akademike, vlerësohet përvoja në punë vullnetare ose në shërbimin profesional publik.
- Aplikantët duhet të paraqesin tri letra rekomandimi nga profesionistë, që e njohin veprimtarinë akademike të aplikantit dhe/ose shërbimin në komunitet.
- Aplikantët duhet të paraqesin një ese me rreth 500 fjalë ku të përshkruajnë aspiratat e karrierës dhe qëllimet e tyre në lidhje me këtë program doktorate.
- Studentët për të cilët anglishtja është gjuhë e dytë duhet të kenë pikët e duhura të TOEFL-it (www.ets.org/toefl), IETLS (www.ielts.org), ose PTE (www.pearsonpte.com). Në rastet kur niveli i gjuhës angleze mund të vërtetohet në mënyra të tjera, ky kriter mund të hiqet për aplikantët.
- Për aplikantët që kanë diplomë master, nuk kërkohen pikët nga GRE (Graduate Record Exam).